



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2022:051418

Datë: 28.02.2024

Numri i dokumentit: 05389325

KPPP.nr.1527/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike, gjyqtari Alajdin Tërshnjaku, në çështjen përmbare të kreditorit Komuna e Prishtinës, kundër debitorit Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, me adresë ish-Pallati i Mediave “Rilindja”, Prishtinë, duke vendosur sipas prapësimit të debitorit të parashtruar kundër Urdhrit Përmbare P.nr.216/16 të datës 28.09.2016 të Zyrës Përmbare VAIS Law me seli në Prishtinë, me datën 20.02.2024, jashtë seancës merr këtë:

AKTVENDIM

- I. Hapet konflikti i kompetencës lëndore mes Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike dhe Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm-divizioni civil për të vendosur në këtë çështje përmbare.
- II. Lënda me komplet shkresat i dërgohet Gjykatës Supreme të Kosovës për ta zgjidhur këtë konflikt të kompetencës lëndore.

A r s y e t i m

Kreditori Komuna e Prishtinës më 27.04.2016 ka parashtruar propozim për përmbare, në Zyrën Përmbare VAIS Law me seli në Prishtinë (më tutje Përmbare), me të cilin ka kërkuar që të detyrohet debitori Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, me adresë në Prishtinë, që t’ia paguaj shumën prej 2,208,110.00 Euro, dhe shpenzimet e procedurës përmbare. Propozimin për përmbare e kishte bazuar në Vendimin Përfundimtar Nr.04/113 të datës 16.01.2023, të nxjerrë nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Përmbaresi më 28.04.2016 e ka nxjerrë urdhrin përmbarimor P.nr.216/16 me të cilin e ka lejuar në tërësi përmbarimin sipas propozimit të kreditorit.

Debitori më 06.05.2016 ka parashtruar prapësim, duke kundërshtuar në tërësi Urdhrin dhe i ka kërkuar gjykatës që ta anuloj atë, ndërsa kreditori më 11.05.2016 ka paraqitur përgjigje në prapësim.

Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil përmes aktvendimit PPP.nr.166/18 të datës 21.03.2023 është shpallur jokompetente në pikëpamje lëndore për trajtimin e çështjes, duke u bazuar në nenin 13 paragrafi 1, nënparagrafi 1 të Ligjit 08/L-015 për Gjykatën Komerciale (më tutje LGjK).

Pas shqyrtimit paraprak të prapësimin, gjykata nga shkresat e lëndës vëren se as kreditori e as debitori nuk janë shoqëri tregtare, rrjedhimisht gjykata në bazë të nenit 19 lidhur me nenin 392 të LPK-së kryesisht e shqyrtoi kompetencën e vet lëndore.

Neni 2 [Fushëveprimi] i LGjK-së shprehimisht ka paraparë se *“Ky ligj zbatohet ndaj të gjithë personave juridikë dhe fizikë, vendorë dhe të huaj përfshirë shoqëritë tregtare të përcaktuara në Ligjin për Shoqëritë Tregtare në Republikën e Kosovës të cilët kanë konteste tregtare ndërmjet tyre”*, ndërsa neni 3 [Përkufizimet] i LGjK-së në par.1 nënpar.1.11 kontestin tregtar e ka definuar si *“çdo kontest mes shoqërive tregtare, shoqërive tregtare dhe subjekteve publike dhe të gjitha konflikteve administrative të shoqërisë tregtare, siç përcaktohet në nenin 13 të këtij Ligji”*.

Në këtë drejtim, neni 13 [Kompetencat e Gjykatës Komerciale] i LGjK-së, në par.1 nënpar.1.2 ka rregulluar se *“Gjykata Komerciale është kompetente për të gjykuar, dhe ka juridiksion ekskluziv për të gjykuar, në Dhomat e Shkallës së Parë dhe Dhomat e Shkallës së Dytë (...) të gjitha mjetet juridike, siç përcaktohet me ligjin e aplikueshëm për procedurën përmbarimore, për çështje brenda kompetencës të kësaj gjykate”*.

Sipas dispozitave të cituara më lartë, LGjK gjen zbatim për personat fizik dhe juridik të huaj dhe vendor në rastet kur kanë kontest tregtar ndërmjet vete (neni 2 i LGjK-së). Sipas nenit 3 par.1.11 të LGjK-së, të cituar më lartë, për t’u konsideruar një mosmarrëveshje juridike kontest tregtar, atëherë duhet të plotësohen kumulativisht dy kushte: a) kontesti të zhvillohet ndërmjet subjekteve të caktuara juridike sipas LGjK-së, dhe b) natyra juridike e kontestit të jetë a paraparë me nenin 13 të LGjK-së.

Sa i përket kriterit të parë, gjykata vë në pah se si subjekte të pranuar me LGjK për ta zhvilluar kontestin tregtar janë (i) dy apo më shumë shoqëri tregtare të cilat janë palë kundërshtare me njëra tjetrën në atë kontest (*çdo kontest mes shoqërive tregtare*), (ii) njëra palë të jetë shoqëri tregtare ndërsa pala tjetër kundërshtare të jetë subjekt publik (*çdo kontest mes shoqërive tregtare dhe subjekteve publike*), dhe (iii) në konfliktin administrativ të jetë e përfshirë të paktën një shoqëri tregtare (*të gjitha konflikteve administrative të shoqërisë tregtare*).

Në rastin konkret, asnjëra palë nuk është shoqëri tregtare. Në njërën anën kreditori është institucion publik i themeluar në bazë të Ligjit nr.03/L-040 Për Vetëqeverisjen Lokale, ndërsa në anën tjetër debitori është institucion publik i themeluar në pajtim me rregulloret e UNMIK-ut Nr.2002/5 dhe nr.2005/15. Pra, të dy palët paraqesin subjekte publike, rrjedhimisht këto dy subjekte nuk mund të kenë kontest tregtar ndërmjet vete në kuptim të LGjK-së.

Lidhur me kriterin e dytë, pra që natyra juridike e kontestit të jetë e paraparë me nenin 13 të LGjK-së, gjykata gjen se mosmarrëveshja juridike mes kreditorit dhe debitorit paraqet çështje përmbarimore të inicuar në këtë gjykatë sipas prapësimit të debitorit, si mjet i rregullt juridik i goditjes së urdhrave përmbarimor, e cila mbulohet me nenin 13 par.1 nënpar.1.2 të LGjK-së. Megjithatë, subjektet procedurale në këtë çështje nuk janë të përshtatshme për ta zhvilluar kontestin tregtar, siç u sqarua më lartë.

Prandaj, në mungesë të kushtit të parë lidhur me subjektin e caktuar për të qenë palë në procedurat para Gjykatës Komerciale, kjo e fundit e konsideron veten si jo kompetente në kuptimin lëndor për të vendosur në këtë çështje juridike.

Meqenëse selia e debitorit është në Prishtinë, atëherë kjo gjykatë gjithashtu vlerëson se pikërisht Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm-divizioni civil, është e kompetencës lëndore dhe territoriale për të vendosur për këtë çështje, siç përcakton neni 5 par.5 i LPP-së lidhur me nenin 20 par.1 të Ligjit 06/L-054 për Gjykatat.

Për këto arsye, kjo gjykatë në bazë të nenit 24 par.1 të LPK dhe nenit 25 par.2 të LPK-së lidhur me nenin 13 par.7 të LGjK-së, gjykata hapi konflikt të kompetencës lëndore.

Gjykata Komerciale e Kosovës
Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike
KPPP.nr.1527/2024, datë 20.02.2024

Gjyqtari
Alajdin Tërshnjaku

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.